

MATILDA PARLLAKU (ÇOLLAKU)

**ASPEKTE MORFOSINTAKSORE TË TË FOLMEVE TË
STUDIUARA NGA J. GJINARI**

1. Çështje dhe dukuri morfosintaksore në këndvështrimin e J. Gjinarit

“E folmja, si një variant i gjuhës dialektore dhe si një degëzim më i imët i saj [...] nuk duhet kuptuar si pjesë e dialektit, por si një sistem i plotë më vete, që përfshihet në makrosistemin e dialektit. Në sistemin gjuhësor të së folmes hyjnë veçoritë që e dallojnë atë nga të folmet e tjera të dialektit e të mbarë gjuhës, hyjnë tiparet e përbashkëta të grupit ku ato bëjnë pjesë, tiparet e grupit më të madh, tiparet e përbashkëta të nëndialektit, tiparet e përbashkëta të dialektit dhe tiparet e përbashkëta të gjuhës kombëtare”¹. Duke mbajtur parasysh pikërisht këtë përfshirje hierarkike të sistemeve tek vijuesi i shkallës më të lartë, J. Gjinari duket se, përveçse në fusha të tjera, ka dhënë një ndihmesë të çmuar në kapërcimin e pengesave për studimin e sintaksës dialektore, si fusha më pak e studiuar, për shkak të vështirësisë që vjen nga mungesa e materialit të mjaftueshëm dialektor të mbledhur në terren.

Në studimet e prof. Gjinarit çështjet sintaksore dhe dukuritë morfosintaksore kanë qenë në fokus në kuadrin e përgjithshëm të të folmeve të studiuara, krahas me dukuritë fonetike, morfologjike dhe me çështjet e fjalëformimit si edhe të leksikut. Në aspektin sintaksor janë studiuar dhe analizuar prej tij kryesisht çështje nga sintaksa e fjalisë, duke sjellë raste të përshtatjes së kallëzuesit me kryefjalën, të ndërtimit të plotësve të llojeve të ndryshme, të rendit të fjalëve në fjali, të përdorimit të infinitivit në fjali, të përpjekjeve për të vënë në dukje shtrirjen e ndërtimeve me folje që tregojnë fillimin e veprimtimit dhe rrugën e zhvillimit të tyre etj.

Në disa të folme ai ka sjellë informacion dhe shembuj edhe për disa çështje të sintaksës së periudhës, duke filluar që nga raportet që vendosen ndërmjet fjalive, për disa lloje fjalish të nënrenditura, foljen kallëzues që përdoret në to dhe mjetin lidhës me të cilin bashkohen me fjalinë kryesore, etj., madje ai ka studiuar edhe mënyrat e ndryshme me të cilat përdoret dhe ndërtohet ligjëratat e drejtë në këto të folme. Autori përdor terminologjinë e gjuhësisë së shekullit XX: *plotës mjeti*, *plotës vendi*, *plotës etik*, *plotës shoqërimi*, *plotës dallimi* etj. apo: *funksion predikativ* (mbiemri në), *predikat*

¹ *Dialektologjia shqiptare*, J. Gjinari, SHBLU, Tiranë, 1988, f. 17.

emëror, përemri i shkurtër, nje sekundare, mbiemër pronor; mbiemra dëftorë; subjektore, objektore etj. Në pjesën më të madhe të të folmeve, subjekt i studimit kanë qenë banorët vendës të brezit të vjetër në ndonjë rast edhe të tre brezave ose nga mosha 40 vjeç e lart, fillimisht për të dokumentuar të folmen në gjendjen e saj të ruajtur, apo edhe për të pasqyruar mënyrën se si ajo ndikohet nga e folmja e brezave të tjerë që banojnë në atë zonë, të cilët kanë kontakte edhe me komunitetet të tjera, janë në lëvizje dhe sjellin prej të folmeve të tjera, forma dhe mënyra të tjera komunikimi.

Në korpusin e përbërë nga këto studime, ne jemi interesuar të vëzhgojmë mënyrën se si ky gjuhëtar i ka parë kategoritë e ndryshme morfologjike, të renditura herë te rubrika “Morfologjia” e herë te “Sintaksa” për të kuptuar bashkëveprimin e këtyre kategorive në aspektin sintaksor (çka e vë në dukje edhe vetë prof. Gjinari, gjatë trajtimit të ndonjë të folmeje, fjala vjen për funksionin sintaksor të infinitivit, që do të sillet në vëmendje më poshtë).

Meqenëse në këto studime qëllimi kryesor i autorit ka qenë konstatimi i veçorive morfologjike e sintaksore të dialektit, nëndialektit, a të folmes përkatëse si mjete komunikimi të kufizuara vetëm në formën e tyre të folur ndërmjet grupeve të njerëzve, bazuar në korpusin e të folmeve të studiuara nga J. Gjinari dhe të veçorive dialektore të nxjerra në pah prej tij, gjatë trajtimit të tyre në punim kemi shprehur mendimin tonë herë duke i grupuar si dukuri të përbashkëta, e herë rast pas rasti për çështje si: formimi i grupeve emërore emër + përemër në funksion të plotësve të llojeve të ndryshme; cili nga funksionet e formës së pashtjelluar paskajore (infinitivit) është konstatuar si i përdorur më tepër në të folme të ndryshme (kur njihet si trajtë foljore në mënyrën lidhore apo si folje e fjalive të nënrenditura subjektore, objektore, kushtore, rrjedhimore etj.); – si ndikon përdorimi në vend të njëra-tjetrës i parafjalëve të rasave të ndryshme para emrave (edhe pse jo të së njëjtës rasë me to) në përcaktimin e funksionit të gjymtyrës së fjalisë, që formohet nga bashkimi i tyre; – se si trajta e mbiemrit ndryshon formën e shprehjes dhe funksionin sintaksor të gjymtyrës që shpreh dhe – se si përdorimi i lidhëzave polisemantike apo edhe mungesa e tyre shërbejnë për të shprehur të njëjtat raporte sintaksore që do të shpreheshin nëpërmjet pranisë së tyre, etj.

2. Harta e të folmeve të studiuara nga J. Gjinari

Vështrimin, vërejtjet, vëzhgimet, vënien në dukje të tipareve, sprovat, mendimet (emra këta që janë pjesë përbërëse të titujve të artikujve të tij), ky dialektolog i shquar i ka shtrirë në një territor gjeografik të gjerë, duke studiuar të folmet e Beratit, Oparit, Skraparit, Myzeqesë, Devollit,

Mallakastrës, Krujës e Malësisë së Krujës, Bregut të Bunës, Krasniqe, Gash, Bytyç, madje edhe me një aspekt të veçantë të së folmes së arbëreshëve të Italisë.

Të folmet e gjashtë rretheve a krahinave të para i përkasin toskërishtes veriore; nga gegërishtja veriore ka studiuar disa nga të folmet e krahinave që bëjnë pjesë në Malësinë e Gjakovës² dhe nga gegërishtja e Shqipërisë së Mesme ka studiuar të folmet e zonës së Krujës dhe Malësisë së Krujës (të cilat, për nga tiparet e identifikuar, Gjinari shprehet se mund të afrohen e mund të radhiten me të folmet e anës veriore të Shqipërisë së Mesme, d.m.th. me ato të Matit dhe të Dibrës³).

Të grupuara sipas veçorive që kanë (të cilat janë zbuluar si të tilla nga studimet e materialit dialektologjik të mbledhur nga J. Gjinari), të folmet e këtyre zonave disa veçori i kanë të përbashkëta si rezultat i pozitës gjeografike dhe përkatësisë së njohur në të folmet e toskërishtes veriore⁴. Pavarësisht këtij klasifikimi, Gjinari vë në dukje se "... e folmja e Mallakastrës e Myzeqesë dhe pjesërisht ajo e Beratit afrohet me gegërishten jugore dhe veriperëndimore, ku foljet dalin me -s në vetën e parë njëjës dhe në tri vetat e shumësit: *godis, godisim, godisni, godisin, kullo* ..."⁵. Në të njëjtën kohë "Të folmet e Beratit, të Myzeqesë, të Skraparit dhe të Mallakastrës largohen prej të folmeve të gegërishtes vetëm për rastet kur rrokja e theksuar që vjen pas zanores -ë fillon me bashkëtingëlloren -r: *varfëri, nusëri, dimëron*."⁶

Kjo shtrirje e studimit të të folmeve është dëshmi e punës së tij të palodhur për të mos u kufizuar me studimin e të folmes së qytetit të tij të lindjes, por duke ndihmuar edhe në studimin e të folmeve të tjera që i përkasin edhe gegërishtes verilindore e veriperëndimore, si edhe duke bërë të njohura (nga ana teorike), jo vetëm për vendasit dhe përdoruesit e këtyre të folmeve, por edhe për studiuesit e interesuar, tipare të përbashkëta e dallime, mes

² "Veçoritë dalluese të të folmes së tri zonave të Tropojës dhe përkatësia e saj në gegërishten verilindore përcaktohen pikërisht nga sistemi foljor." *Vërejtje mbi të folmen e krahinave Krasniqe, Gash e Bytyç të rrethit të Tropojës*, BUSHT SSHSH, 1962/4, f. 185.

³ *Vëzhgime mbi të folmen e Krujës dhe Malësisë së Krujës, I*, SF 1964/3, f. 133.

⁴ Në toskërinë veriore bëjnë pjesë: krahina e Myzeqesë, Berati me Nahijen e tij, Krahina e Mallakastrës, krahina e Skraparit, qarku i Korçës me zonat: Opar, Gorë, Fusha e Korçës, Devoll, Pogradec, Kolonjë, Leskovik..." *Toskërishtja veriore dhe grupimi i të folmeve të saj*, në Konferenca I e Studimeve albanologjike (nëntor 1962), Tiranë, 1965, f. 241.

⁵ *Dialektologjia*, J. Gjinari, Gj. Shkurtaç, Botimi II, Tiranë, 2003, f. 223.

⁶ Po ata, po aty, f. 193.

dialekteve, nëndialekteve e në mënyrë më specifike, mes të folmeve në veri e jug të Shqipërisë.

3. Dukuri të përbashkëta dhe dallime mes të folmeve të studiuara nga J. Gjinari

Të analizosh në aspektin gramatikor një segment të ligjërimit a të një të folmeje do të thotë t'i shikosh ato në njërin anë nga ana e formës (morfologjikisht) dhe nga ana e funksioneve (sintaksorisht) që elementet përbërëse vendosin mes tyre. Në morfosintaksë analizohet mungesa e njeve para emrave / mbiemrave / përemrave, përdorimi i pjesëzave dhe elementeve ndihmëse, (mos) / përdorimi a dyfishimi i përemrave vetorë a trajtave të shkurtra, përdorimi i kohëve të mbipërbëra, sistemi rasor, zgjedhimi i foljeve; nga pikëpamja sintaksore: mjetet sintaksore (lidhëzat), llojet e fjalive, rendi i fjalëve në fjali. Këtë lidhje mes këtyre dy pjesëve të gramatikës dhe vënien e morfologjisë në funksion të shprehjes së marrëdhënieve sintaksore, prof. Gjinari e shpjegon edhe gjatë trajtimit të ndonjë të folmeje, siç është rasti i të folmes së krahinave Krasniqe, Gash, Bytyç, ku shprehet për funksionin sintaktik të infinitivit (pasi ka theksuar në kreun e morfologjisë ekzistencën e tij), si subjekt, si objekt apo si folje kallëzues e fjalive të varura subjektore e objektore, madje dhe atyre kushtore e qëllimore apo edhe si kallëzues i ndonjë fjalie të pavarur, pyetëse a urdhërore⁷.

Dallimet mes dialekteve dhe në mënyrë zbritëse më të detajuar, edhe ndërmjet të folmeve, ai i përlij me faktin që ato më të rëndësishmet në strukturën gramatikore shkaktohen nga ekzistenca e disa formave gramatikore në dialektin verior dhe mungesa e tyre në jugorin. Konkretisht mungesa e përemrave pronorë vetvetorë dhe e kohëve të përbëra (e kryera e dytë dhe e kryera e plotë e dytë, si edhe paskajorja geqe), të cilat sjellin dallime edhe në sintaksë. “Dallimet e tjera të qenësishme në strukturë shkaktohen prej mënyrave të ndryshme të ndërtimit të formave të disa pjesë të ligjëratës dhe herëherë edhe prej përdorimit sintaktik të ndonjëres prej tyre.”⁸

Kurse në lidhje me stadin ku ndodhen sot dhe raportet që dialektet, nëndialektet dhe grupet e të folmeve kanë me njëri-tjetrin ai shprehet që “... veçoritë e përbashkëta dhe dalluese (mes tyre) kanë lindur në periudha të ndryshme dhe janë formuar kohë më kohë gjatë divergjimit e konvergjitimit që ka ndodhur zakonisht ndërmjet të folmeve të njërit dialekt të sotshëm e

⁷ *Vërejtje mbi të folmen e krahinave Krasniqe, Gash e Bytyç të rrethit të Tropojës*, BUSHT SSHSH, 1962/4, f. 193.

⁸ *Sprovë për një ndarje dialektore të gjuhës shqipe*, SF, 1966/4, f. 104.

herëherë edhe ndërmjet disa të folmeve të të dy dialekteve. Disa veçori dalluese janë të hershme.”⁹

Si dukuri të përbashkët për të folmet e toskërishtes veriore, në aspektin morfosintaksor ai numëron praninë e *rasës vendore*¹⁰, tek emrat, të cilët shërbejnë për të ndërtuar plotësit e vendit apo edhe plotësin e shoqërimit; apo të prirë nga parafjala *me* për të shprehur plotësin e mjetit (sot kundrinor me parafjalë që tregon mjetin me të cilin kryhet veprimi): *qo trunk ja preu kokën me këllëçt, ai i ra me thikët, e goditi me (h)ut*.

Kjo dukuri është përgjithësuar në tekstin e Dialektologjisë, ku theksohet që “kjo formë e përbërë nga tema e kallëzores dhe nga mbaresa -t(ë) (rasa vendore), që prihet gjithmonë nga parafjalët: *në, mbi, nën, nëpër, përmbi, me dhe për*, është karakteristike për të folmet që ndodhen midis lumenjve Mat dhe Vjosë (Shqipëria e Mesme dhe Toskëria veriore)¹¹.

Mbeturina të rasës vendore, që janë studiuar duke biseduar dhe duke i regjistruar kryesisht personat e moshuar të brezit të vjetër, për të konstatuar pikërisht gjendjen e ruajtur të dialektit dhe të së folmes përkatëse, përdoren edhe sot në këto të folme.

Dukuria e përdorimit të parafjalës së rasës emërore *nga*, në vend të parafjalës së rasës rrjedhore del më e qartë nëpërmjet dallimit të dy shembujve të mëposhtëm: 1. *njimëthi erdha nga pshati*, 2. *erdha nga djali, po z’vinjam* (në shembullin e dytë këtu vëmë re që parafjala *nga* mund të ishte prej ose edhe *për*, duke kuptuar: “erdha prej djalit” (për hatër të djalit, ngaqë është djali) etj., se përndryshe, s’vija)¹². Pavarësisht se nuk janë specifikuar llojet e plotësve, nga shembujt del e qartë që bëhet fjalë për *plotës rrethane*, kryesisht *vendi* (sot rrethanorë vendi) ose për *plotës agjenti, vepronjësi* (sot kundrinorë me parafjalë).

Nëpërmjet dy shembujve të shprehjes së plotësit të vendit me emra me parafjalë të rasës kallëzore, *mbë* e *ndë*, Gjinari sjell një dukuri të shkrirjes së këtyre dy parafjalëve me emrat përkatësisht *udhë* dhe *anë*, për të formuar

⁹ *Po ai, po aty*, f. 116: “Në fazën e sotshme të zhvillimit të shqipes, duke filluar që prej Rilindjes, konvergimi i të folmeve dhe i dialekteve paraqitet si një fenomen i vetëm dhe sa vete e kryhet me një shpejtësi më të madhe.”

¹⁰ Për numrin e rasave të pranuar në gramatologjinë shqiptare ka pasur studime e diskutime të ndryshme dhe “Si rregull, janë pranuar e pranohen pesë rasa: emërore, gjinore, dhanore, kallëzore e rrjedhore. Por në disa gramatika pranohen edhe rasat vendore e thirrore. Për sa i përket rasës vendore, argumentohet se ka ekzistuar historikisht, por nuk është më aktive në shqipen e sotme.” L. Buxheli, “*Modelet e caktimit rator në gjuhën e sotme shqipe*”, Neraida, Tiranë, 2007, f. 37.

¹¹ *Dialektologjia*, J. Gjinari, Gj. Shkurtaj, Botimi II, Tiranë, 2003, f. 216-217.

¹² *E folmja e qytetit të Beratit*, Buletin për Shkencat Shoqërore, Botim i Institutit të Shkencave, Tiranë 1957, f. 123.

një ndajfolje dhe për të shprehur të njëjtën gjymtyrë fjalie, plotësin e vendit por tashmë me një kategori tjetër. Është interesant të vërehet që dy plotësa vendi (vetëm këta të dy) kanë qenë njëherë në rasën kallëzore me parafjalët *mbë* e *ndë* dhe pastaj kanë kaluar në rrjedhore duke mbajtur të shkrija në vetvete edhe parafjalët që kishin në kallëzore “mbudhës takova Stavrin” (mbë udhë takova Stavrin) dhe “ndanës jan ca burime” (ndë anë jan ca burime)¹³.

Përveç plotësve të vendit e të mjetit, Gjinari ka konstatuar përdorimin edhe të plotësve të kohës, të cilët në të folmen e Beratit i ka gjetur të shprehur me grupet emërore të përbëra nga emrat: *herë, ditë, natë, drekë, darkë* të prirë nga përmiri dëftor i vetës së tretë në rastën kallëzore: *atë*, ose nga nyja joshqese *një*. Në raste të tilla ajo që vihet re është se, pavarësisht se përmiri ruan rasën që ka, pra *kallëzoren*, emri vendoset në rasën *rrjedhore* duke dhënë: *atë dite /një dite, atë /një (h) ere*¹⁴.

Gjatë analizës së materialit dialektologjik të kësaj të folmeje, vëmendjen e tij e ka tërhequr edhe përdorimi në trajtën e shquar i mbiemrit në funksionin e gjymtyrës emërore të kallëzuesit emëror “mbiemri në rolin e predikatit emror” kur shoqërohet me një qëndrim emocional të folësit (kënaqësi/moskënaqësi): *Shum i miri është ai djali; Sa i urti që ai psonjsi i par!*¹⁵

Për trajtat e shkurtra të përdorshme në të folmen e Beratit, ai shpjegon se edhe për vetën e tretë shumë të rasës dhanore, sikurse edhe për kallëzoren, gjejmë trajtën *i*, shumë rrallë trajtën e rregullt *u*: “*i ipën kuajve dhe ikën; plaka u tha nuseve*” si dhe trajtat e bashkuara: *nai, jau, ja* (përkundrejt formave të rregullta: *na e, ua, ia* etj.): “*Nai kërkuan që vjet çupën, po s’e dham se ishte e vogël. Jau theu xhamet era.*”

Për çështjen e paskajores dhe shkallën e përhapjes së saj në dialektet e shqipes, J. Gjinari shprehet se, “si në të gjitha të folmet e jugut, mungon paskajorja dhe, në vend të saj, përdoret ose lokucioni *për të + pjesoren* që në Morfologji e ka quajtur *mënyrë foljeje*, ose mënyra lidhore: a) *kishte lënë një penxhere për të ryr*; b) *se z dinte të gjente.*”¹⁶

Dukuria e rendit të fjalëve në fjali është studiuar në të folmen e Bregut të Bunës¹⁷ dhe në atë të Oparit¹⁸. Në të dyja këto të folme është marrë në shqyrtim e njëjta çështje, ajo e pozicionit që zë *pjesëza përemërore*¹⁹ apo

¹³ Po aty, po atje.

¹⁴ Po aty, po atje.

¹⁵ Po aty, f. 124.

¹⁶ *E folmja e Skraparit*, BUSHT SSHSH, 1958/1.

¹⁷ *Vëzhgime mbi të folmen e Bregut të Bunës*, në: “Dialektologjia shqiptare”, I, 1971.

¹⁸ *Një vështrim mbi të folmet e Oparit*, BUSHT SSHSH, 1957/1.

¹⁹ *Vëzhgime mbi të folmen e Bregut të Bunës*, në: “Dialektologjia shqiptare”, I, 1971, f. 335.

*përemri i shkurtuar*²⁰ në raport me foljen në vetën e dytë në mënyrën urdhërore. Në të dyja rastet, pavarësisht shembujve të ndryshëm dukuria rezulton të jetë e njëjtë, pozicioni është *enklitik* kur ato bashkohen me një folje dhe *proklitik*, kur ka dy folje përkatësisht: *çoe, kaloe, shkruje* ndërsa: *shko ma thirr*²¹; dhe: *mbau, lëshoe, xgidhe*, ndërsa: *ec i thuaj, del i thirr*.²²

Në të folmen e Bregut të Bunës për këtë çështje jepet edhe një shembull tjetër për pozicionin e pjesëzës përemërore *u* tek folja në vetën e dytë shumës. Ndryshe nga rendi që njihet tashmë në gjuhën letrare dhe në disa të folme të tjera, ku trajta e shkurtër zë vend ndërmjet temës dhe mbaresës së foljes: *merreni, silleni*, në këtë të fome, kjo pjesëz vendoset pas mbaresës: *merrne (merreni), prenje (prejeni), çonu (çohuni)*²³. Një ndërtim i tillë, – shprehet Gjinari, – vërehet edhe në të folme të tjera të gegërishtes veriore të Krasniqe, Gash, Bytyç²⁴.

Për të folmet e krahinës së Oparit²⁵, të Skraparit²⁶ dhe në pjesën fshatare të krahinës së Beratit²⁷ si edhe në të folmen e Mallakastrës²⁸ është përgjithësuar dukuria e ruajtjes së mbaresës së gjinisë mashkullore, edhe gjatë kalimit në numrin shumës të emrave ambigjenë që ata përcaktojnë, duke vënë në dukje dy raste përjashtimi për dy emra me origjinë turke: *Lisa të thatë, puse të fellë; themele të trashë*; dhe dy shembujt e sjellë si raste përjashtimore që i nënshtrohen ndryshimeve të njohura në dukurinë e ndërrimit të gjinisë tek emrat e mbiemrat ambigjenë: *ato bakshishe dhe irate të mëdha*²⁹.

²⁰ *Një vështrim mbi të folmet e Oparit*, BUSHT SSHSH, 1957/1, f. 145.

²¹ *Vëzhgime mbi të folmen e Bregut të Bunës*, në: “Dialektologjia shqiptare”, I, 1971, f. 355-356: “Pjesëza përemërore *u* dhe përemrat e shkurtër të vetës III (vetëm ose së bashku me objektin e drejtë a të zhdrejtë) bashkohen me foljen në mënyrë enklitike: *çoe, kaloe, shkruje*. Kur përemri është në vetën e parë rri përpara foljes, kur folja në urdhërore prihet nga një folje tjetër: *shko ma thirr*.”

²² *Një vështrim mbi të folmet e Oparit*, BUSHT SSHSH, 1957/1, f. 145: “Përemri i shkurtuar + urdhërore: proklitik kur janë dy folje: *ec i thuaj, del i thirr* dhe enklitik kur bashkohet vetëm me një folje: *mbau, lëshoe, xgidhe*.”

²³ *Vëzhgime mbi të folmen e Bregut të Bunës*, në: “Dialektologjia shqiptare”, I, 1971, f. 356.

²⁴ *Vërejtje mbi të folmen e krahinave Krasniqe, Gash e Bytyç të rrethit të Tropojës*, BUSHT SSHSH, 1962/4, f. 188: “... kuqne, shtrengonu, mbytnu.”

²⁵ *Një vështrim mbi të folmet e Oparit*, BUSHT SSHSH, 1957/1.

²⁶ *E folmja e Skraparit*, BUSHT SSHSH, 1958/1.

²⁷ *E folmja e qytetit të Beratit*, Buletin për Shkencat Shoqërore, Botim i Institutit të Shkencave, Tiranë 1957.

²⁸ *Vërejtje mbi të folmen e krahinës së Mallakastrës*, BUSHT SSHSH, 1962/3.

²⁹ *Një vështrim mbi të folmet e Oparit*, BUSHT SSHSH, 1957/1, f. 149.

Veçori tjetër për këtë zonë është edhe funksioni i mjetit lidhës që për bashkimin e fjalive drejtuese me të nënrenditurat 1) kohore, 2) vendore, 3) lidhore (si përemër lidhor, shënimi ynë), 4) rrjedhore³⁰.

E folmja e Mallakastrës është e folmja në të cilën janë trajtuar më shumë çështje të aspektit morfosintaksor si: – përshtatja e kallëzuesit me kryefjalën, kur është emër kolektiv, mënyra e ndërtimit të plotësve të ndryshëm, *vendi, kohe, dallimi, mënyre*, përdorimi i parafjalëve në vend të njëra-tjetrës, kryesisht *ato të rrjedhores*, në vend të parafjalëve të *kallëzores* rasë që mban emri, para të cilit vendosen, apo edhe grupet emërore që formohen me nyjën apo dëftorin në rasën kallëzore që i shtohen emrit që, pavarësisht rasës së tyre, vendoset në rrjedhore.

Çështje që kanë të bëjnë me sintaksën e periudhës, raportet që fjalitë vendosin ndërmjet tyre, si edhe mjetet lidhëse që përdoren për bashkimin e tyre janë sjellë nëpërmjet shembujve të periudhave me raporte bashkërenditjeje ndërmjet fjalive, kryesisht *kundërshtore* apo edhe *këpujore*, por gjithashtu edhe me raporte varësie: *shkakore qëllimore, lidhore a kushtore* që lidhen mes tyre asindetikisht (*asintetisht* siç thotë Gjinari) pa lidhëza: *Ajo është lop tamëm, qy thot jo. Mali me malt s piqen, njeriu me njerit, piqet. Nji pënd qe vuri ai, një pënd vura un. Shkakore: Kot që t rrij ai, nashti pjeprat u mbaruan. Qëllimore: U mundua atijen ai ta shikonte mbreti qysh i hante. Lidhore: Ata m at ko do ken qen si t egër, s mirin vesh. Kushtore: Do mirje nqit lek, do paguanje një e gjysëm. Do punoç, do març*³¹.

Lidhja nënrenditëse trajtohet në rubrikën “*ndërtimi i fjalive të varura*” nëpërmjet shembujve që sillen për fjalitë e nënrenditura *kushtore*, duke treguar mungesën e mjetit lidhës (lidhëzës kushtore) në ato fjali kushtore a) që fillojnë me folje kallëzues në mënyrën lidhore: “Të jet për tër një, mir, po s esht” si edhe një shembull i ndërtimit të një fjalie të nënrenditur kushtore b) që e ka foljen në mënyrën dëftore dhe bashkohet me drejtuesen me lidhëzën *kur*: “Kur jan kaq re t forta, na i çpon qy?!”; për fjalitë e nënrenditura *shkakore, kohore* që bashkohen me kryesoren me lidhëzat *te, tek*: “Tek se kuptoi, kurr se ka për të kuptuar. Tek uli kokën, e pa.” Me lidhëzën *si*: “Si un s sho vet, them se s shon t tër.” *Na puna që* si lidhëz alternative e *meqenëse*: *Atje janë bregje bregje, na puna që jan punuar.*³²

³⁰ 1) *Si iku djelli një copë, që dolli ajo që brënda, athere këtë e liroj gjumi*; 2) *Mbreti përpara pallatit na kishte kavenenë që mbante sazexhinjtë; asaj që fujmë djathë, i themi shakull; u shtiu krypë dhe i çoj në konak që flinte*; 3) *na ka vajtur te pallati mbretit, që ishte n`at qytet; i ra ndërmënt e dashura që kishte dashuri*; 4) *na ishte një herë Arshik Garipi, i binte qemanes, që nuk kishte në botët.* Po aty, f. 150.

³¹ *Vërejtje mbi të folmen e krahinës së Mallakastrës*, BUSHT SSHSH, 1962/3, f. 171.

³² Po aty, po atje.

Disa nga nga dukuritë e konstatuara në të folmet e studiuara nga J. Gjinari dhe të risjella në vëmendje e të shoqëruara me opinionin tonë gjatë kësaj trajtесе në mënyrë më të përmbledhur janë si më poshtë:

- Përdorimi i rasës vendore (kryesisht në të folmet e toskërishtes veriore);
- Ruajtja e gjinisë mashkullore të mbiemrave me funksionin - *përcaktorë*- të emrave ambigjenë (Berat, Opar, Myzeqe);
- Prania e formave kohore të mbipërbëra foljore³³ (Krasniqe/Gash/Bytyç; Bregu i Bunës; Krujë, Malësi e Krujës);
- Prania e nyjes së prapme -*t* tek emrat në rrjedhore në funksionin e përcaktorëve me drejtim (Krujë, Malësi e Krujës);
- Përdorimi i nyjës -*e* në vend të nyjës -*të* edhe në rastet e përcaktorit kallëzuesor që i referohet një kundrinori³⁴;
- Trajta dhe rendi i mbiemrit - *predikat emëror*;
- Vendosja në shumës e kallëzuesit të përshtatur me kryefjalën - *emër kolektiv* (Opar, Skrapar, Myzeqe, Mallakastër);
- Përdorimi i parafjalëve në vend të njëra-tjetrës (Berat, Myzeqe, Devoll);
- Rendi i fjalëve në fjali (ruajtja dhe ndërrimi) (Berat, Opar, Krasniqe/Gash/Bytyç; Bregu i Bunës);
- Elidimi i nyjes së përparme (Bregu i Bunës; Krujë, Malësi e Krujës);
- Prania përkatësisht mungesa e paskajores geqe (me+pjesore) (mungon në të folmet e toskërishtes dhe funksionin e saj e kryen lidhorja ose ndërtimi për të + pjesore);
- Ndërtimi i fjalitë së nënrenditur kushtore (me lidhëzën *po*) me folje në të tashmen e dëftores³⁵.

³³ *Vërejtje mbi të folmen e krahinave Krasniqe, Gash e Bytyç të rrethit të Tropojës*, BUSHT SSHSH, 1962/4, f. 187: “Nga trajtat foljore të dëftores interes paraqesin ajo e së kryerës e foljeve jokalimtare, ajo e së kryerës së dytë, ajo e së kryerës së plotë të dytë... *veç na s e kem pa marr vesh* (kemi pase marrë); *kish pa pã ni hãⁿd'ër* (kishte pasë pamë)”.

³⁴ “Si në shumë të folme veriore, edhe këtu një mbiemër i nyjshëm me funksion predikativ del me nyjen sekondare e, sikurse mbiemri që ka funksion atributiv: *kem pas edhe rrugn e largët; e kem vendin e ftoft ktu.*” *Vërejtje mbi të folmen e krahinave Krasniqe, Gash e Bytyç të rrethit të Tropojës*, BUSHT SSHSH, 1962/4, f. 192.

³⁵ Fjalitë e nënrenditura kushtore që bashkohen me drejtuesen me lidhëzën kushtore *po* e kanë foljen kallëzues, kryesisht në mënyrën lidhore, rrallë edhe të të kryerën e thjeshtë të mënyrës dëftore, kurse tek shembujt që ka sjellë J. Gjinari folja është në kohën e tashme të mënyrës dëftore ose në mënyrën habitore: “*Po s'ka bur shtëpia, nuk bën dot gjë. Njeriut, po s'i arthka vakti, s'e gjen gjë.*”

Dukurinë e elidimit të nyjës së përparme para emrave në gjinore dhe para mbiemrit, përveçse në të folmen e Bregut të Bunës, Gjinari e ka vënë në dukje edhe në të folmen e Krujës, sidomos në rastet e emrave mashkullorë: *prefti shkret, plaku katunit*, por, në Malësinë e Krujës ai vë re që takohet edhe dukuria e kundërt, ajo e pranisë së saj, *shplaka e dorës, fmija e burrit*³⁶.

Pavarësisht ngjashmërive në të folmet e Krujës dhe Malësisë së Krujës, prof. Gjinari ka vënë në dukje edhe dallimet, një nga të cilët është edhe prania e paskajores me *për të* dhe me *për+emër foljor asnjans* të pashquar: ajo përdoret më shumë në qytet se në Malësi³⁷.

Përfundime

Nga gjithë sa trajtuam më sipër në lidhje me të gjitha ndihmesat që J. Gjinari ka sjellë në aspektin morfosintaksor mund të nxjerrim disa përfundime:

Terminologjia specifike që ai ka përdorur është karakteristike për gjuhësinë e shekullit në të cilin ai jetoi e studioi dhe kjo, jo vetëm për faktin se vitet gjatë të cilave janë shkruar artikujt e sipërcituar datojnë para standardizimit të gjuhës shqipe, por edhe janë plotësisht në përputhje me terminologjinë gramatikore të asaj periudhe. Por, para së gjithash, ai vetë është përpjekur që, edhe në të shkruar, sidomos në disa raste, t'i qëndrojë besnik të folmes së krahinës së origjinës së vet.

Materiali dialektor nga i cili janë nxjerrë veçoritë e këtyre të folmeve është mbledhur kryesisht nga brezi i vjetër dhe më tepër sesa karakter krahases (për të vënë në dukje evolucionin historik të të folmeve nga një brez në tjetrin), studimet e tyre kanë karakter konstatues dhe pasqyrojnë gjendjen e ruajtur të së fomes përkatëse.

Dukuria e përdorimit të parafjalëve në vend të njëra-tjetrës (apo edhe e lidhëzave), që duket të jetë trajtuar në thujt të gjitha të folmet e studiuara nga J. Gjinari, është dukuri tipike sintaksore, sepse janë pikërisht këto fjalë ndihmëse a shërbyese që shërbejnë për shprehjen e raporteve sintaksore që vendosen midis njësive të ndryshme sintaksore³⁸. Po kështu edhe dukuritë e tjera të trajtuara nga J. Gjinari në të folmet e studiuara prej tij si, pranëvënia asindetike, rendi i gjymtyrëve dhe fjalive, janë gjithashtu mjete të shprehjes së raporteve sintaksore.

³⁶ *Vëzhgime mbi të folmen e Krujës dhe Malësisë së Krujës, I*, SF 1964/3, f. 105.

³⁷ *Vëzhgime mbi të folmen e Krujës dhe Malësisë së Krujës, I*, SF 1964/3, f. 122: “po s’ pate gjâ° m`i dhâ°n me hâ°ngër dhe s`kena për t` shkou kurkuni”.

³⁸ ASHRSH, IGJL, *Gramatika e gjuhës shqipe II, Sintaksa*, Tiranë, 1997, f. 65-69.

Në kushtet e gjuhës së shkruar përdorimin e parafjalëve në vend të njëra-tjetrës, brenda së njëjtës rasë apo për rasta të tjera do ta kishim konsideruar si një rast të ekonomisë gjuhësore, për aq kohë sa përdoruesit e tyre arrinin të komunikonin, pa pengesë, por, në kushtet e gjuhës së folur, kur komunikimi ndërmjet tyre realizohet brenda komunitetit ku të gjithë kanë të njëjtat rregulla të pashkruara gramatikore, edhe nga përdorimi i parafjalëve të kallëzores për rrjedhoren apo anasjellas, nuk shkaktohet asnjë mosmarrëveshje, përkundrazi, një përdorim i ndryshëm i kësaj dukurie do t'u tingëllonte i çuditshëm, duke e veçuar folësin përkatës si pjesëtar i një komuniteti të ndryshëm nga i tyri. Në aspektin sintaksor një përdorim i tillë i parafjalëve të rasave të ndryshme në vend të njëra-tjetrës sjell për rrjedhim edhe ndryshimin e funksioneve sintaksore të gjymtyrës që formohet nga ky bashkëveprim, jonormativ.

Dukuria e përdorimit të mjetit lidhës *që*, jo vetëm në funksionin e përemrit lidhor, apo edhe në atë të lidhëzës ftilluese që bashkon fjalinë drejtuese me një fjali kryefjalore, kallëzuesore, kundrinore, por edhe fjali të tjera të nënrenditura si: *kohore*, *vendore a përmbyllëse*, është karakteristike për të folmen e Beratit, por edhe atë të Oparit (siç u trajtua më sipër) ku, veç këtyre fjalive, numërohet dhe sillen shembuj edhe për fjalinë e nënrenditur *rrjedhore*, sikurse është po aq e veçantë dhe karakteristike po në këtë të folme, si edhe në disa të tjera, mungesa e paskajores (*gege*), funksionin e së cilës e kryen *mënyra lidhore* ose lokucioni foljor *për të + pjesore*.

Ndërtimi i fjalive kushtore me formën e pashtjelluar *pa + pjesore*, si mjet alternativ i shprehjes së raporteve kushtore në periudhën me fjali kushtore, si edhe përdorimi i lidhëzës kundërshtore *po*, si *përmbyllëse*, janë disa nga veçoritë sintaksore që e dallojnë të folmen e Beratit, si e folmja përfaqësuese e toskërishtes veriore, disa nga tiparet dialektore të së cilës janë të përbashkëta edhe për të folmet e zonave përreth saj.

Vënia në dukje e dukurisë së përdorimit të nyjes *-e* kur duhet të ishte nyja *-të*, në rastet e përcaktorit kallëzuesor që i referohet kundrinorit, e konstatuar në disa nga folmet, kryesisht ato të gegërishtes, siç u citua më sipër, na ndihmon ta kuptojmë si një veçori që i dallon këto të folme edhe nga të folmet e tjera që i përkasin dialektit a nëndialekteve të tjera, edhe nga gjuha letrare, në të cilën, është pikërisht prania e kësaj nyjeje që e bën dallimin e dy gjymtyrëve të ndryshme të fjalisë *përcaktorit* nga *përcaktori kallëzuesor*, pavarësisht, nëse ky i fundit është i renditur pas emrit.

Duket se, pavarësisht trajtimit në disa prej këtyre të folmeve, më të kufizuara në studimet e tij janë çështjet që kanë të bëjnë me sintaksën e periudhës, jo vetëm rastet kur fjalitë bashkohen me mjete lidhëse, por edhe ato kur fjalitë bashkohen me pranëvënie.

Është i njohur tashmë fakti që mjetet lidhëse janë më të kufizuara në dialekt, pikërisht falë spontaneitetit që ofron forma e folur, ku folësit komunikojnë me ndërtime të atypëratyshme, pa u menduar gjatë për përdorimin e mjeteve lidhëse apo dhe për detyrimin për t'iu përmbajtur rregullave gramatikore, madje më sipër u njohëm edhe me raste, kur një mjet lidhës përdorej për bashkimin e shumë llojeve të fjalive drejtuese me ato nënrenditëse apo njëri mjet lidhës përdorej në vend të tjetrit. Mungesa e mjeteve lidhëse bën që të marrë përparësi përdorimi i fjalive që bashkohen asindetikisht, duke e thjeshtëzuar dhe bërë më të rrjedhshëm ligjërimin e folur, jashtë kornizave detyruese.

Dukuritë e konstatuara dhe të vëna në dukje nëpërmjet studimit të këtyre të folmeve vënë në dukje interesimin e J. Gjinarit, këtij studiuesi të rrallë, për t'i hyrë sa më në thellësi veçorive të këtyre të folmeve. Nëpërmjet gjithë studimeve të sjella së pari në ndihmë të banorëve të zonave, të folmet e të cilave ka studiuar, por edhe në ndihmë të gjuhëtarëve, arrijmë të kuptojmë, që, edhe pse materiali që ka studiuar, është mbledhur si i tillë në një periudhë shumë të hershme, për një kohë të shkurtër dhe në formë të folur, nëpërmjet intervistave apo bisedave, arrin të vërë në dukje që dukuritë fonetike dhe gramatikore (morfologjike e sintaksore) si edhe leksikore që janë pjesë përbërëse e këtyre të folmeve, duhet të vijojnë të studiohen dhe, nëpërmjet krahasimit, do të mund të zbulohet evoluimi i tyre, prej asaj periudhe, deri në ditët e sotme.

BIBLIOGRAFI

- ASHRSH, IGJL, *Gramatika e gjuhës shqipe I, Morfologjia*, Tiranë, 1995.
 ASHRSH, IGJL, *Gramatika e gjuhës shqipe II, Sintaksa*, Tiranë, 1997.
 Buxheli, L., *Modelet e caktimit rasor në gjuhën e sotme shqipe*, Neraida, Tiranë, 2007.
 Floqi, S., *Skicë e së folmes së Dangëllisë*, në BUSH, SSHSH, 1958/3.
 Gjinari, J., *Dialektologjia shqiptare*, SHBLU, Tiranë, 1988.
 Gjinari, J., Shkurtaç, Gj., *Dialektologjia shqiptare* (botimi II, i përmirësuar), UT, FHF, Tiranë, 2003.
 Gjinari, J., *Një vështrim mbi të folmet e Oparit*, BUSHT SSHSH, 1957/1.
 Gjinari, J., *E folmja e qytetit të Beratit*, Buletin Shkencor Shkodër, 1957/1.
 Gjinari, J., *E folmja e Skraparit*, BUSHT SSHSH, 1958/1.
 Gjinari, J., *Mbi të folmen e Devollit*, BUSHT SSHSH, 1960/4.
 Gjinari, J., *Vërejtje mbi të folmen e krahinës së Mallakastrës*, BUSHT SSHSH, 1962/3.

- Gjinari, J., *Vërejtje mbi të folmen e krahinave Krasniqe, Gash e Bytyç të rrethit të Tropojës*, BUSHT SSHSH, 1962/4.
- Gjinari, J., *Vëzhgime mbi të folmen e Krujës dhe Malësisë së Krujës*, I, SF 1964/3.
- Gjinari, J., *Vëzhgime mbi të folme të Krujës dhe Malësisë së Krujës*, II, SF, 1964/4.
- Gjinari, J., *Tipare të të folmeve të toskërishtes veriore të njëjtë me të gegërishtes jugore*, SF, 1965/2.
- Gjinari, J., *Toskërishtja veriore dhe grupimi i të folmeve të saj*, në “Konferenca I e Studimeve albanologjike” (nëntor 1962), Tiranë, 1965.
- Gjinari, J., *Sprovë për një ndarje dialektore të gjuhës shqipe*, SF, 1966/4, f. 99-118.
- Gjinari, J., *Vëzhgime mbi të folmen e Bregut të Bunës*, në: “Dialektologjia shqiptare”, I, 1971.
- Gjinari, J., *Tipare të të folmeve të toskërishtes veriore të njëjtë me të gegërishtes jugore*, SF, 1965/2.
- Gjinari, J., *Për historinë e dialekteve të gjuhës shqipe*, SF, 1968/4.
- Gjinari, J., *Ndërtime me folje që tregojnë fillimin e veprimit në të folmet e arbëreshëve të Italisë*, SF, 1975/3.
- Riza, S., *Emrat në shqipe: Sistemi i rasavet dhe tipet e lakimit* (punim historik me dy shtojca kritike) USHT, IHGJ, Tiranë, 1965.
- Totoni, M., *Çështje të studimit të sintaksës dialektore*, SF, 1978/4.

SUMMARY

MORPHOSYNTACTIC ASPECTS OF SPEECHES STUDIED FROM JORGJI GJINARI

Due to the early and continuous studies of J. Gjinari in some of the linguistics fields, especially on the dialectology one, we have today the opportunity to become acquainted with, analyze and compare the specific linguistic characteristics of the speeches of different areas in Albania, the separation ways of dialects, their relationship with the standard language, etc.

In this paper we will try to point out, in our view, the contribution of this well-known dialectologist to the remarkable studies on morphosyntactic terms of some issues. According to Gjinari, the affiliation of the speeches of the respective dialects highlights the distinctive features of each part of speech, including: verbs, nouns, adjectives, etc.

Morphology, in its turn, modifies the meaning of words and their syntactic features, namely the nature of the relations they establish with other words, and also helps in their linking with each-other in clauses or sentences, although we are dealing with the verbal form of the language. This study will help us understand the “coexistence” of morphology (in syntactic terms) with syntax in the speeches that J. Gjinari has studied, bringing thus another contribution to the study of the dialectical syntax, which is a less studied field in the Albanian studies of dialects.